



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 379 /2020
Data: 30.06.2020

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 23.06.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i korniza afatmesme buxhetore 2021-2023.
3. Shqyrtimi i informatës për sektorin e emergjencave.
4. Shqyrtimi i informatës mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i korniza afatmesme buxhetore 2021-2023.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- komuna e Hanit të Elezit pasi ka pranuar qarkoren e parë buxhetore dhe drejtoria i ka marr gjitha masat për me përgatitur dhe sot në KPF e keni kornizën afat mesme buxhetore 2021-2023. Për shifra më në detale mund të na shpjegon drejtori për buxhet dhe financa.

Shabi Rexhallari thekson:- para se me u përgatitur kjo nga Ministria e Financave na është dërguar qarkorja buxhetore që janë të specifikuar të gjitha burimet e financimit gandi i përgjithshëm gandi i arsimit dhe të hyrat vetanake për vitin 2021, 2022 dhe 2023. Duke u bazuar në qarkoren buxhetore buxheti për vitin 2021 do të jetë 2, 590, 312.00 € duke shënuar një rënie prej 151,783 € ose për 5.54% do të jetë më i ulët se në vitin 2020. Në vitin 2022 do të kemi një masë të buxhetit në lartësi prej 3,154,853 €, kurse në vitin 2023 do të kemi një buxhet në lartësi prej 3,255,290 €. Nga ky buxhet që është paraparë për vitin 2021, shpërndarja sipas kategorive ekonomike do të jetë në paga dhe shtesa në shumë prej 1,540,658.00 €, në mallra dhe shërbime në shumë prej 329,258.00 €, në shpenzime komunale në shumë prej 60,000.00 €, në subvencione dhe transfere në shumë prej 67,940.00 € dhe në kategorinë investime kapitale në shumë prej 592,456.00 €. Është mbajtur diskutimi publikë për kornizën afat mesme buxhetore. Në kuadër të kornizës janë paraparë objektivat. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse buxheti është më i vogël se në vitin paraprakë si ka mundësi me u kryer projektet, objektivat e sidomos projekti i ujësjellësit që është katastrofë në Han të Elezit dhe a ka projekt të shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit. Edhe në kuvend e kam diskutuar por përsëri e parashtror çështjen e trafos dhe kanalizimit në fshatin Pustenik dhe kërkoj që të hynë si kategori e veçantë çështja e këtyre dy projekteve .

Shabi Rexhallari thekson:- sa i përket çështjes së projektit të ujit për vitin e ardhshëm janë planifikuar 100 000 € dhe CDI-ja ka startuar në këtë vit që të bëjë ngritjen e kapaciteteve të ujit . Sa i përket kanalizimeve ne e kemi të theksuar rregullimin e kanalizimeve nëpër zonat urbane dhe rurale por deri në miratim të buxhetit drejtoria do të bëjë paramasat dhe paralogaritë e projekteve në mënyrë që të jenë më detale se në cilin vit do të hyjnë.

Refet Kalisi thekson:- jemi në kontakte me CDI-në dhe ata e kanë marr përsipër për ndërrimin e gypave të cilët janë të dëmtuar dhe funksionalizimin e fabrikës.

Nexhmedin Daci thekson:- si kodë për çdo vit e kemi rregullimin e kanalizimeve në zonat rurale por nuk jemi përcaktuar se për cilat kanalizime por kjo çështje duhet të diskutohet e duhet të bisedohet me pronarët privat se a lejojnë , mirëpo ende nuk jemi përcaktuar se për cilat kanalizime por ka fundi i vitit i shikojmë nevojat.

Kryesuesi thekson:-çështja e pronave për Lagjen Brava dhe Lagjen Ballazhi është e zgjidhur por problemi është te Lagjja e Dacve dhe kryetari kërkon që me marr përsipër që mos me na penguar dhe ne nuk mund ta marrim përsipër për te Lagjja Daci.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket shtimit të kapaciteteve të ujit a keni ndonjë foto të shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit për shkak se gypat ndërrohen ku dihet se ku janë dhe dihet ku kanë probleme , mirëpo në Han të Elezit në bazë të informacioneve që kam nuk ka ndonjë rrjet ku dihet se ka shkon. E para do të ishte më mirë të bëhet shtrirja e rrjetit të gypave të ujësjellësit e pastaj të bëhet funksionalizimi i fabrikës. Siç shihet kompania “Bifurkacioni” nuk është e interesuar me shtuar kapacitetin e ujit sepse nuk keni edhe marrëveshje për shtim të kapaciteteve të ujit dhe marrëveshja që është bërë në mes kryetarit të komunës dhe drejtorit të kompanisë “Bifurkacioni” është bërë për çështje të tjera e jo për shtim të kapaciteteve të ujit . Neve na duhet të shtohen kapacitete e ujit e jo për me menaxhuar për shkak se po i bien që nuk po dimë me menaxhuar dhe e kemi marr kompanin regjionale të Ferizajt. Unë disa herë kam kërkuar që në mbledhje të kuvendit të komunës të jetë prezentë drejtori në mënyrë që të jep sqarime dhe shohim se cili është problemi. Unë nuk kam informacione që ka pengesa sa i përket kanalizimit në fshatin Pustenik por si do që të jetë pavarësisht pengesave rrugën nuk mundet me ndaluar askush dhe është mirë që me u krijuar një komision profesional për

këtë çështje dhe me përcaktuar trasenë dhe pavarësisht çështjeve që dalin mund të bisedohen për shkak se kërkon një zgjidhje urgjente. Edhe trafvoja duhet të bëhet sepse nuk ka problem pronësorë por vetëm duhet të ketë interesim dhe vullnet me kryer.

Kryesuesi thekson:- përmenda çështjen e Lagjes së Dacëve për shkak se mendohet që traseja me shkuar edhe nga Lagja Bushi dhe me u lidhur me kanalizimin e Lagjes së Ujit të Thartë, ndërsa nëse vjen për rrugë Lagjja Daci nuk ka kyçje por nuk na pengon askush.

Nora Xhoni thekson:- në planifikime ishte edhe zhvillimi i turizmit rural dhe pasi që kjo është në planifikime patjetër duhet të bëhet kanalizimi dhe trafvoja.

Mallzum Qajani thekson:- sa i përket Pustenikut është menduar por nuk ka një version definitivë apo alternativë se si do të zgjidhet por nëse vendosim me bërë kanalizimin duhet të vendosim për të gjitha lagjet në fshatin Pustenik në mënyrë që të zgjidhet ai problem një herë e për gjithmonë. Se cili do të jetë versioni definitivë ne nuk kemi vendosë për arsye se nuk kemi bërë paramas dhe parallogari . Ekzistojnë projekte ekzakto se ka shkon uji i Hanit të Elezit kur është shtruar rrjeti sekondarë në Han të Elezit dhe rrjeti i CDI-së që është bërë në vitin 2008 , ndërsa për rrjetet e vjetra është shumë e vërtetë që ka shumë gypa. E ka përcjellë një dukuri negative për arsye se komuna e Hanit të Elezit ka ujë por uji i pishëm nuk është . Ne po presim që përmes CDI-së me zgjidhë këtë problem por kemi planifikuar edhe mjete financiare të komunës të cilat do të jenë pjesë edhe e shtimit por besoj që do të ja arrimë me shtuar një pjesë të sasisë dhe me vendosur në kontroll pjesën e qendrës së Hanit të Elezit por kjo varet prej dinamikës së punëve të cilën do ta bënë CDI-ja. Për çështje të rrymës me KEDS-in shpesh kemi biseduar që fshatin Pustenik me kthyer me rrymë të Hanit të Elezit për arsye se është me rrym të fshatit Kotlinë dhe nuk kemi potencuar që nuk kemi hasur në mirëkuptim por jo me nisur me punuar . Çështja e trafos është obligim i KEDS-it dhe ne nuk potencojmë që nuk participojmë, mirëpo çështja e zgjidhjes së rrymës në Pustenik është prioritet i kryetarit të komunës i përhershëm por se a do të arrihet në vitin 2020 nuk e di për shkak të koronavirusit.

Refet Kalisi thekson:- në vitin 2019 është bërë fizibilitetit i ujit në Han të Elezit, Gllloboçicë dhe Gorancë dhe po ashtu është regjistruar rrjeti i ujësellsit në Han të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- një prioritet nuk mund të jetë qe dhjetë vite por mundë të jetë një deri të tri vite sepse nëse nuk kryhet brenda tri viteve e humb efektin e prioritetit. Çështja e rrymës është diskutuar që shumë vite që do të kthehet me Han të Elezit dhe si prioritet është diskutuar dhe është vendosur por asnjë herë nuk është ndërmarr asgjë. Sa i përket trafos nuk mund të themi se është inati për shkak se komuna investon dhe trafvoja mbetet pronë e KEDS-it dhe me inati nuk mund t'i qojmë punët sepse edhe njësorët e rrymës elektrike i kemi blerë një kohë dhe kanë dal pronë e KEDS-it dhe nuk mund ta presim KEDS-in se ndoshta edhe tridhjetë vite nuk e rregullon por ne duhet me i bërë zgjidhje qytetarëve. Drejtoria për Shërbime publike është mirë që deri te Ura e Fezës të vendosen shportat për mbeturina.

Mallzum Qajani thekson:-unë mendoj se nuk është punë inati por është obligim i KEDS-it.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2021-2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i informatës për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- gjatë këtyre muajve ka qenë pandemi dhe sektori i emergjencave ka kryer punë të cilat edhe nuk i kanë takuar duke bërë dezinfektimin e rrugëve të objekteve parqeve. Në tabel i keni të gjitha aktivitetet që i kanë pasur gjatë katër muajve.

Tetuta Shkreta thekson:- te pishat në fshatin Gorancë a ekziston mundësia me u përcaktuar një pjesë dhe me u vendosë një tabel që vetëm në atë pjesë mund të dhezet zjarri për pjekje të flijove apo edhe për zgar

Refet Kalisi thekson:- do t'i shikojmë mundësitë në të ardhmen për këtë çështje por edhe qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR SEKTORIN E EMERGJENCAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i informatës mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhemdin Daci thekson:- ne kemi filluar me proceduarën e legalizimeve në fillim të muajit qershor dhe në bazë të Ligjit të Ri procedurat janë shumë më të thjeshta por edhe kostoja është më unike në tërë territorin e Republikës por nuk ka interesim aq shumë dhe nuk kanë paraparë mekanizëm për me i nxitur më shumë qytetarët për me bërë legalizimin.

Sabedin Hasallari thekson:- kërkesë për legalizim a duhet të paraqesin edhe qytetarë të cilët kanë bërë ndërtime para lufte. Çështja e pagesave a është e njëjtë apo varësisht prej komunave ndryshon.

Nexhemdin Daci thekson:- edhe ata të cilët kanë ndërtuar para lufte por edhe ndërtimet deri në vitin 2004 lirohen nga pagesa e taksës, ndërsa nga viti 2005 paguajn taksë. Për çdo legalizim duhet të bëhen matjet gjeodezike. Pagesa për çështje të legalizimit është e njëjtë në nivel të Kosovës.

Kryesuesi thekson:- edhe më herët ligji ka ekzistuar por nuk ka mundur me u zbatuar për shkak se ka pasur kosto por me ligjin e ri nuk kërkohet plan por raporti gjeodezik është i kushtueshëm dhe nuk pajtohem për shkak se duhet të paguhet aq sa paguan taks në komunë që i bien se nëse e ke shtëpinë 200 m² duhesh ta paguash 200 € raportin gjeodezikë dhe 200 € taksën në komunë. Unë kryetarin e kam dëgjuar në diskutime që ka potencuar se do të thjeshtohet ligji që përmes një skice dhe tri dokumente me u kryer legalizimi. Po ta shikoni ligjin dhe udhëzimet shumë thjeshtë e paraqet dhe potencon që katër dokumentet të thjeshta pa ekspertizë por me një raport gjeodezikë dhe taksën komunale , ndërsa në realitet gjeodeti duhet të paguhet aq sa e pagunë taksën komunale . Unë kam menduar se do të bëhet zgjidhje me këtë ligj në tërë Kosovën por mendoj që ka me dështuar dhe mendoj që është dashur me i marr praktikrat edhe në rajon. Po të ishte që përmes një skice të thjeshtë dhe procedurat e tjera komuna me i kryer pa mjete financiare por vetëm taksën prej një euro, ndërsa me këtë kosto jo vetëm në Han të Elezit por në nivel të Kosovës përsëri kanë me vazhduar afatin për shkak se nuk ka me pasur efekt sepse ka kosto.

Nexhemdin Daci thekson:- taksa për legalizimin objektit është shumë e lirë dhe të gjithë jemi për drejtësi dhe për shtetit por çdo kush që aplikon për leje ndërtimore i del dy herë më shtrenjtë se sa legalizimi. Kjo është për interes të qytetarëve për shkak se në të ardhmen secili ka me hasur në probleme se çdo objekt duhet të regjistrohet në kadastër sepse edhe nëse donë me shitur në të ardhme nuk mundesh pa e pasur të legalizuar. Raportit gjeodezike bëhet nga kompanitë e licencuara të gjeodetëve por edhe ata i kanë të përcaktuara taksat nga niveli qendrorë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

